



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 2381 Prot.

Fier, më 20.01 2026

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER

PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53, pika 4, nenit 56, pika 2, shkronja "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier, e cila do të zhvillohet në sallën e këshillit **ditën e Premte, datë 27.02.2026, ora 14:30**, me këtë rend dite:

1. **Miratimi i Rendit të Ditës.**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 29.01.2026.**
3. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e kalendarit vjetor të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fier për vitin 2026"

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Etikës, Standardeve dhe Apelimeve.

4. **Projekt–vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Janar 2026."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

5. **Projekt–vendim:** "Për shpërndarjen e një banese sociale me qira, e cila rezulton e lirë nga administrimi i banesave sociale me qira pranë bllokut të Banesave Sociale, Lagjja '16 Prilli', Fier, për familjet e pastreha."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

6. **Projekt–vendim:** "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

7. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e ndryshimit (shtesë fondesh nga fondet e trashëguara të vitit 2025) në VKB nr. 118, datë 11.12.2025, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026’.”

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

8. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për familjet e fshatrave të Njësisë Administrative Levan nga përmbytjet e shkaktuara nga lumi Vjosa në datën 08.01.2026, si dhe për familjet e Njësisë Administrative Nr. 2 Mbrostar Ura dhe Libofshë nga përmbytjet e shkaktuara nga lumi Seman në datën 11.01.2026.

Komisioni Përgjegjës: “Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.”

9. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi’ z. Miti Nushi dhe z. Llazar Pove.”

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Arsimit, Sporteve, Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit, Dhënies së Titujve, Emërtimeve, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritetit European.

10. Informacion Këshillit : “Mbi Raportin e Monitorimit 12-mujor të Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025”

11. Diskutime dhe komente.

Kryetar Këshilli
Antoneta Çunaj

